

Breaking News:

Rezultatet kryesore të strukturave policore në vend dhe ngjarjet e ndodhura gjatë 24 orëve të fundit.





Lajmet

Operacionet

28/06/2026

Krujë/Finalizohet Operacioni I Koduar “Black 2”, Arrestohet 1 Shtetas Që Qarkullonte I Armatosur

Krujë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Black 2”.

Qarkullonte i armatosur me armë zjarri pistoletë, kapet në rrethrotullimin e Rinasit nga shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Krujë, një 31-vjeçar nga Lezha.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë dhe municion luftarak.

Shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Krujë, bazuar në informacionet operative për një shtetas që qarkullonte i armatosur, në kuadër të operacionit policor të koduar “Black 2”, e lokalizuan atë në rrethrotullimin e Rinasit, ku e kapën dhe e arrestuan në flagrancë shtetasin T. M., 31 vjeç, banues në Lezhë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin me të cilin ai qarkullonte, shërbimet e Policisë gjetën në një çantë dore një armë zjarri pistoletë, me një krehër me municion. Arma e zjarrit dhe municioni u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve luftarake dhe e municionit”.



Krujë/Finalizohet operacioni i koduar “Black 2”, arrestohet 1 shtet

Policia e Shtetit





Watch on

◀ Dhërmi/Mbeti i bllokuar në thellësi të Kanioneve të Gjipesë, Policia ndihmon 45-vjeçarin

Tiranë/Arrestohen 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

 GET IT ON
Google Play

 Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

>

Arkiva

>

Akademia e Sigurisë

>

Ministria e Brendshme

>

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

>

Interpol

>

Europol

>

Misioni PAMECA V

>

SCPA

>

Projekti Trivalent